



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:004964  
Datë: 04.10.2024  
Numri i dokumentit: 06252798

**K.DH.Shk II.nr.1083/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit “Raiffesien Bank Kosovë” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Robert Dol”, nr. 99, kundër debitorëve: 1. N.T.Sh. “Focus”, me numër të biznesit 70693062 dhe seli në Raushiq, Komuna e Pejës; 2. J.F. me numër personal ... dhe adresë në Raushiq, Komuna e Pejës; 3. Xh.F. me numër personal ... dhe adresë në Raushiq, Komuna e Pejës, si dhe; M.G. me numër personal .... dhe adresë në Ozdrim, Komuna e Pejës, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të tretë, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1619/22 të datës 05.04.2024, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit të tretë Xh.F., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1619/22 të datës 05.04.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1619/22 të datës 05.04.2024, ne dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit të tretë Xh.F., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 388/21, i lejuar me datë 14.12.2021, nga Përmbaruesi Privat Fatmir Baloku.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitori i tretë, (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e

Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1619/22 të datës 05.04.2024, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditore ka ushtruar përgjigje ne ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se aktvendimi i shkallës së parë është plotësisht i bazuar dhe i mbështetur në gjendjen faktike si dhe dispozitat ligjore. Andaj, gjykatës së shkallës së dytë i ka propozuar që ankesën e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1619/22 të datës 05.04.2024.

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Raiffeisen Bank Sh.A., ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 388/21, të datës 14.12.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin ndaj debitorëve N.T.Sh. "Focus", 2. J.F. me numër personal ... dhe adresë në Raushiq, Komuna e Pejës; 3. Xh.F. me numër personal ... dhe adresë në Raushiq, Komuna e Pejës, si dhe; M.G. me numër personal ... dhe adresë në Ozdrim, Komuna e Pejës, në bazë të Kontratës së Pengut për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi kredinë me nr. 200705459, e datës 30.12.2016 e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me Nr. R-20170112-196, të datës 12.01.2017, për realizimin e kredisë në lartësi prej EUR 10,284.04 së bashku me kamatat e rregullta dhe kamatëvonesën, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori Xh.F., brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetim se debitorit i është dorëzuar vetëm urdhri përmbartimor pa shkresa përcjellëse. Ndërsa, ka shtuar se dokumenti përmbartues nuk ka titull ekzekutiv apo tipare të përmbartueshmërisë dhe se nuk dihet nëse kredia është bërë e arritshme konform nenit 30 të LPP-së. Në fund, ka theksuar se organi përmbartues është dashur që konform neni 102 të LPK-së, propozimin e propozuesit ta kthej në plotësim. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Kreditore, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe se nuk gjen mbështetje në nenin 71 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se propozimi për përmbartim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 38 të LPP-së ngase është treguar dokumenti përmbartimor në kopje të vërtetuar dhe se i njëjti dokument përbën dokument përmbartimor në kuptim të nenit 22.1, pika 1.7 a) të LPP-së. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ashtu që urdhri mbi lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave ne lëndë, ka

nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.141/2023 të datës 31.01.2024, përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të tretë Xh.F., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 388/21, i lejuar me datë 14.12.2021, nga Përmbarruesi Privat Fatmir Baloku.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Kontratën mbi Pengun për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja e kredisë nr. 200705459, gjeti se e njëjta është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengut Nr. R-20170112-196, dhe si e tillë përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i plotëson kushtet ligjore nga neni 22 pika 1.7a dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë e përmbarrueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarrim.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të neni 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së neni 22 par.1 nën par 1.7 dhe me neni 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore ku në mesin e dokumenteve përmbarrimore në bazë të cilave organi përmbarrues mund të caktoj përmbarrimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkalles se Dytë, vlerëson se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor paraqet dokument përmbarrimor, për faktin se në rastin konkret përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin duke u bazuar në Kontratën e Pengut për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi kredinë me nr. 200705459, e datës 30.12.2016 e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me Nr. R-20170112-196, të datës 12.01.2017 dhe te njëjtat paraqesin dokumente përmbarruese në kuptim të dispozitës së neni 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, me të cilën parashihet se “1. *Dokumente përmbarruese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore me neni 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragraf i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjta mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II nr.1083/24. me datë 02.10.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**